Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/23
Datë: 02.02.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet** dhe **rivalidohet** institucioni "Star Nails Academy", SH.P.K , me adresë: Rr. 28 Nëntori, Dardani, Prishtinë, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 29.02.2024 deri 28.02.2029, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK);

   1.1. Manikyrist/e, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim kombëtar profesional (D), me 4 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në 22 grupe brenda një vit kalendarik me nga 5 kandidat në grup, numri maksimal i kandidatëve që mund të trajnohen brenda vitit kalendarik është 110 kandidatë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Star Nails Academy" me datë 20.04.2023 ka parashtruar në AKK kërkesën për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin Manikyrist/e niveli III i KKK, e cila është protokoluar dhe ka marrë numër 01/182.
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK sipas legjislacionit në fuqi.
Ekipi i Eksperteve me datë 26.10.2023 ka bërë shqyrtimin e dokumentacionit nga dosja e aplikimit, ndërsa me datë 02.11.2023 ka realizuar vizitën në këtë institucion.

Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve me datë 09.11.2023 ka përpiluar raportin përfundimtar dhe ka dhënë vlerësim pozitiv sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve nga ana e institucionit, të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për riakreditim dhe rivalidim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe certifikues; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin "Star Nails Academy" si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës institucioni "Star Nails Academy" për riakreditim dhe rivalidim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhënë në raportin e vlerësimit për këtë institucion, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Star Nails Academy"
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK -së